

VENDIM
Nr. 312, datë 30.10.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SHPK, PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË
BARRËS SIGURUESE DHE HIPOTEKËS) TË ASETVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika “b”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2305/2 prot., datë 27.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Karavasta Solar’ sh.p.k. për marrjen e miratimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2305 prot., datë 17.10.2023, shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. (si palë huamarrëse) ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese dhe hipotekës) përkatësisht të aseteve të kësaj shoqërie në projektin solar të Karavastës prej 140 mw, ndaj palës huadhënëse (e përbërë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Intesa SanPaolo Bank Albania sh.a. dhe Privredna Banka Zagreb - Dionicko Drustvo), ku shoqëria Intesa SanPaolo Bank Albania sh.a. vepron si agjent i mjeteve të ekzekutimit.

- Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të centralit fotovoltai, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 9.5.2022 dhe është mbajtëse e licencës nr. 506, seria P22.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”, “h”, “i” dhe “j”; pikat 3, 4 dhe 6.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

- Neni 7, pika 1, “Një përshkrim i të licencuarit” që përmban informacion:

- germa “f” Mbi efektet e pritshme që kjo procedurë mund të ketë në aktivitetin për të cilin është licencuar.

- Në vijim, do t’i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije arsyet e marrjes së një kredie me të madhe në vlerë se kontrata e zhvillimit të projektit me MIE-n.

- Nga vlerësimi i aseteve në listat e përcjella në ERE, rezulton se jo të gjitha pasuritë e cituara si pjesë të shtojcës A janë asete fikse, ndaj nevojitet të saktësohen listat me shoqërinë “Karavasta Solar” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese dhe hipotekës) të aseteve fikse të saj.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë, palën huadhënëse, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti